

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Keshilli Prokurorial i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	250-25-4597-1-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **Ritender Furnizim me materiale promocionale zyrtare të dizajnuara dhe të shtypura për nevojat e sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

A.R.F. SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Xheve Lladrovci

(Adresa)

Fushë Kosovë

12000

(Vendi)

(Kodi postar)

045 503 888

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Resmi Koca

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

arfshpk.a@gmail.com

(Adresa elektronike)

03.07.2025.

(Data e parashtrimit të kërkesës)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontrate publikuar me datën: 26.05.2025
- Dosja e tenderit e datës: 26.05.2025
- Afati i dorëzimit të tenderëve 16.06.2025
- Data e hapjes së tenderëve 16.06.2025
- Dokumentet që dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës (nën b dhe c).18.06.2025
- Njoftimi mbi vendimin e AK 20.06.2025
- Kërkesa për rishqyrtim 23.06.2025
- Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim 26.06.2025.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet



A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Ne përputhje me nenin 108/a të LPP kemi parashtruar Kërkesë për rishqyrtim brenda afateve kohore, respektivisht me datë 23.06.2025. Me datë 26.06.2025 AK ka nxjerr Vendimin për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 56 i LPP - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 59 i LPP - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve



- Neni 40 i Rregullores se prokurimit publik - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 62 i LPP-se Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
- Neni 43 i Rregullores se prokurimit publik - Ndërprerja e procedurave të prokurimit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1

Në përputhje me nenin 56.3 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), dëshirojmë të paraqesim ankesën tonë ndaj vendimit për eliminimin e ofertës së paraqitur nga ne ARF SHPK, me arsyetimin se mungon "Foto Moster te prezantuar klor ku janë montuar me herët" sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues.

Bazë ligjore dhe sqarim:

Neni 56.3 i LPP-së përcakton qartë se:

"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."

Ne Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është përcaktuar:

Kërkesa 1.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme, në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Në vlerë prej jo më pak se 86,250.00€.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 1. Lista e kontratave duhet të dorzohet e skenuar origjinale të jetë e nënshkruar dhe e vëlosur nga OE. Duke specifikuar emërin e projektit, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe të mbarimit të kontratës dhe referenca apo raporte të pranimit. Referencat apo raportet e pranimit duhet të korrespondojnë në listën e kontratave.

Kërkesa 2.



Për pozicionet 10,11,12,15,16,17,43,45,69.Duhët të prezantohën Mostrat

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 2.Mostrat për pozicionet e kërkuara.

Pra, në Dosjen e Tenderit (DT), konkretisht në seksionin mbi kërkesat për kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, është përcaktuar si në vijim:

Kërkesa:

Për pozicionet 10,11,12,15,16,17,43,45,69.Duhët të prezantohën Mostrat

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

.Mostrat për pozicionet e kërkuara.

Pra, DT nuk figuron asnjë kërkesë sipas arsyes se eliminimit si me poshtë;

20.06.2025

Prishtine Këshilli Prokurorial i Kosoves-Sekretariati

A.R.F. SH.P.K.601582986

Nr. i Prokurimit:	PSH250	2	5	4	5	9	7	1	2	1
-------------------	--------	---	---	---	---	---	---	---	---	---

Titulli: Ritender Furnizim me materiale promocionale zyrtare të dizajnuara dhe të shtypura për nevojat e sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj Kërkesa e juaj për pjesëmarrje është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:Ju jeni eliminuar sepse tek mostra me numër 17 Baner / Pano nuk është prezantuar në mostrat e ofruara "Foto Mostër të prezentuar kolor ku janë montuar më herët"

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qenë në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesin për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt, Teuta Krasniqi

[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

[Nënshkrimi]

Vendimi i AK për eliminimin e ofertës sonë për shkak të kinse mungesës së një foto kolor, përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 56.3 të LPP, pasi ky nuk është kriter i përcaktuar si kusht për kualifikim apo si pjesë përbërëse e ofertës.



Për më tepër, me këtë veprim, AK ka cenuar edhe **nenin 59 të LPP**, i cili ndalon ndryshimin e kriterëve pas shpalljes së njoftimit të kontratës dhe ndalon diskualifikimin e ofertave për arsye të paqarta apo të pa objektivuara në dokumentacionin tenderues.

Neve e kemi implementuar kontratat me numër te protokollit: 912/2023 te datës 07.06.2023 dhe 1292/2024 te datës 08.08.2024 me te njëjtin AK për materiale te njëjta dhe nuk kemi patur asnjë vërejtje dhe materialet tona i gjenden ne pronësi te AK-se pra materialet për secilin pozicion kështu që AK nuk ka kurrfarë dilema lidhur me materialet tona e lere më te na eliminoj për një foto te një materiali, ku qe 24 muaj te gjitha shërbimet e shtypjes se atij pozicioni janë bere nga kompania jone ku për këtë kemi edhe referenca për realizimin e punëve sipas kontratave, si dhe ne me datën 08.05.2023 kemi kërkuar sqarime shtesë pikërisht për këtë pozicion ku na është aprovuar vetëm te sjellët një cope e materialit, ku duke pare qe ne vitin 2024 dhe tani ne 2025 tek ai pozicion NUK është ndryshuar asnjë fjale e vetme, dhe ne mostrat i kemi dorëzuar prape ne te njëjtën formë duke marr për baze aprovimin e sqarimeve ne vitin 2023 ku kemi bere nënshkrimin e kontratës si dhe mostrat e vitit 2024 ku prape kemi bere nënshkrimin e kontratës.

Kërkesa per sqarime e vitit 2023

Foto 21 Baner / Pano

Baner /pano për mur me llogo, me shlyp, me dizajn, me mekanizëm përçjellës për vendosje dhe montim, me mekanizëm lëvizës, me ngritje dhe ulje, me gjithë elementet përçjellëse për funksionalizim të plotë, kornizim, ngjyra të ndryshme dhe sipas nevojave të AK.

Dizajni dhe forma: (Bëhet sipas kërkesës së AK)

Foto Mostër të prezentuar klor ku janë montuar më herët

Kërkesa per sqarime

Ju lutemi te na dergoni dimensionet si dhe ju lutemi te eshte jalu per Roli L P me mekanizem shly foto e bashkangitje



Pasqirto ju keto foto teqesin mates m2, ju lutemi te na sqarohet me saktësiht se qfar duhet te doretam moster per kete pozicion sepse NUK është e precizuar shumt qarte



SPECIFIKIMI TEKNIK I VITIT 2023,2024 DHE 2025

17	Baner / Pano	<p>Baner /pano për mur me llogo, me shlyp, me dizajn, me mekanizëm përçjellës për vendosje dhe montim, me mekanizëm lëvizës, me ngritje dhe ulje, me gjithë elementet përçjellëse për funksionalizim të plotë, kornizim, ngjyra të ndryshme dhe sipas nevojave të AK.</p> <p>(Përcaktohet nga AK)</p> <p>Dizajni dhe forma: (Bëhet sipas kërkesës së AK)</p> <p>Foto Mostër të prezentuar klor ku janë montuar më herët</p>
----	--------------	---

Neni 43.5 i Rregullores përcakton

“Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

- asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
- numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);



- d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
- f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- g. asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
- h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
- i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
- j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose
- k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP”.

Në këtë rast konkret, **asnjë nga këto kushte nuk qëndron**, për arsye se:

- Është paraqitur një ofertë (oferta jonë);
- **Oferta jonë është konsideruar si e përgjegjshme pasi që AK na ka kërkuar edhe vërtetimet e ATK-se dhe Gjykatës të cilat me datën 18.06.2025 i kemi ngarkuar në sistem si dhe kemi dorëzuar në mënyrë fizike tek AK, çka nënkupton se ka pasur vlerësim profesional nga ana e Komisionit vlerësues dhe, për rrjedhojë, kjo ofertë nuk mund të konsiderohet e papranueshme.**

Anulimi i procedurës është bërë në mënyrë të paarsyeshme dhe në kundërshtim me **nenin 43.5 të Rregullores për Prokurim Publik**, duke keqpërdorur diskrecionin dhe duke tejkaluar kompetencat që ia njeh ligji Autoritetit Kontraktues.

Fakti që **anëtarët e komisionit kanë vlerësuar ofertën si të përgjegjshme** tregon se:

- Oferta jonë ka qenë e përgjegjshme.
- Edhe pse njëherë është vlerësuar dhe ka përfunduar procesi i vlerësimit dhe na janë kërkuar dokumentet e gjykatës e ATK-se, AK para se ta anuloi këtë procedure, nëse ka patur ndonjë dilemë, është dashur që të përfundohej procesi i vlerësimit përmes konsultimit dhe verifikimit të qartë ligjor, ku AK e ka në dispozicion nenin 59.2 dhe 72 për sqarime shtese e jo përmes anulimit;
- Anulimi, në këtë rast, është përdorur si mjet për të shmangur përfundimin e procesit dhe për të anashkaluar ofertën tonë.

Neve me datën 23.06.2025 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-se ku i kemi dhënë të gjitha pretendimet tona si në këtë ankese por AK as që ka marrë mundin të na



shqyrtoj pretendimet tona bile as qe i ka permend te gjitha pretendimet por vetem na e refuzon kerkesen tone per rishqyrtim me arsyetimin si ne vijim:

Autoriteti kontraktues ne njoftim per kontrat dhe ne FDT te *Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale pika 9.1& 9.2 te Kapaciteti teknik dhe profesional, te pika*

2.Për pozicionet 10,11,12,15,16,17,43,45,69.Duhet të prezantohen Mostrat

Dëshmi: 2.Mostrat për pozicionet e kërkuara.

Për pozicionin nr 17 te specifikat teknike është kërkuar nga AK-ja:

Baner / Pano

Baner /pano për mur me llogo, me shtyp, me dizajn, me mekanizëm përcjellës për vendosje dhe montim, me mekanizëm lëvizës, me ngritje dhe ulje, me gjithë elementet përcjellëse për funksionalizim të plotë, kornizim, ngjyra të ndryshme dhe sipas nevojave të AK.
(Përcaktohet nga AK)

Dizajni dhe forma: (Bëhet sipas kërkesës së AK)

Foto Mostër të prezentuar kolor ku janë montuar më herët

Ndërsa ju si Operator Ekonomik nuk keni dorzuar Foto mostër ku keni montuar me herët , pra ju si OË nuk i përmbusheni kërkesat të parapara nga AK-ja në Njoftim për Kontratë dhe në FDT ku edhe mostrat janë pjes e FDT. Dhe e njëjta ka qen kërkes për vlerësim.

Kur një AK për një aktivitet të prokurimit korkon Mostra për pozicionet e kërkuara , si mund të thuhet që nuk jan pjes e Dosjes

Andaj, kto pretendime janë të pa bazuar.

Neve i kemi dorëzuar te gjitha mostrat qe i ka kërkuar AK, tani AK qe po arsyetohet lidhur me Aneksin 1 kinse nuk e kemi plotësuar është e padrejte pasi qe ne Aneksin 1 janë specifikimet e detyrueshme te mostrave se si duhet te jene siç janë përbërja madhësia dizajni etj por jo edhe foto ku vet AK ka dhënë foto (**Fotografi Ilustruese**) se si duhet te duken mostrat psh mostra me numër 40, 43, 61, 62, 63, 64 etj pra vet AK ka dhënë foto se si duhen te duken mostrat, për me tepër siç e sqaruam me larte neve kemi vendosur pozicionin e 17 tek AK ne dy kontratat e mëparshme dhe AK është e njoftuar me mostrat tona me punën tone pra e din se si i punojmë dhe si i vendosim për atë edhe na ka kërkuar vërtetimet pra nuk kemi patur kurrfarë vërejtje nga komisioni i vlerësimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet r'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.



Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke eliminuar padrejtësisht ofertën tonë, gjë që ka shkaktuar pasoja të drejtpërdrejta materiale, përfshirë:

- Kostot e përgatitjes së ofertës dhe dokumentacionit mbështetës;
- Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontrate të mundshme;
- Pengesën në realizimin e investimeve të planifikuara për këtë aktivitet.

Për këto arsye, duke u mbështetur në Ligjin për Prokurimin Publik dhe rregulloren përkatëse, kërkojmë nga OSHP që:

1. **Të anulojë Njoftimin mbi Vendimin e datës 20.06.2025;**
2. **Dhe AK të na ftoj për nënshkrimin e kontratës pasi që i kemi dorëzuar vërtetimet.**

Kjo kërkesë është në funksion të respektimit të parimeve të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. *një kopje e Njoftimit mbi kontrate*
2. *një kopje e Kërkeses për rishqyrtim*
3. *një kopje të vendimit të AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
4. *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

